Protokoll.
Konvencion midis shtetit
shqiptar dhe Standard
Oil Company.

Bâmun në Tiranë . . . . . 1925 midis Shkëlqesisë Tij Mininistrit Punve Botore e Bulqësisë, e në emën të Qeverisë Shqyptarë (që në sa vazhdon ka me u emnue Qeria) më njanën anë; edhe Zotnisë Eugene S. Sheffield, i ngarkuem me fuqië prej Standard Oil Company of New-York, që banon në New-York City, Shtetet e Bashkueme të Amerikës Broadway N. 26 (që në sa vazhdon ka m' u emnue Kompania emën ky që shënon Kompaninë në fjalë si edhe ata që përfaqësojnë të drejtat e saja (ses ayants droits) sa herë qi teksti i këtij konvencioni e lyp ose e pranon), më tjatër anë;

U caktue edhe u lith ç' ka vijon:

Neni I

(a) Tue fillue qysh më 12 Maj 1925, Qeveria i njef Kompanisë të drejtën për me zgjeth mbi krejt sypërfaqen e Shtetit Shqyptar, pa kurë farë restrikcioni posë atyneve të paragrafit »b„ të këtij neni, syperfaqe që tänsisht nuk kalojnë nje maximum prej tet-dhetë mijë hektarë me qëllim me bâ mbi këto studime gieollogjike e me kërkue petroll, bitum, gaz natural, argjile bituminoze edhe schiste që kanë aftësi me dhanë petroll me anë të dli-

rimit (destillation).

Tue filluc prej datës të nënshkrimit të këtij konvencioni, Qeveria angazhohet mos mos me koncedue as një misi të tretë (à nukune tierce partie) as në një të drejtë petrolli e cila të mund të zbatohet para datës 12 Maj 1925.

b) Se Kompania nuk ka me pas të drejtën me zgjedh, mbas paragrafit „a„ të këtij neni, as një sypërfaqe që misa të tretë do të kenë zgjedh, për me bâ kerkime ose shfrytzime të lândave të përmënduna, si mbas (conformement) të drejtave të koncedueme këtyneve prej Qeverisë para datës të nenshkrimit të këtij konvensioni.

c) Të zgjedhunit e sypërfaqes prej tetë-dhetë mijë hektaresh duhet t' i komunikohet Qeverisë para datës 30 Qershuer 1925.

d) Këto tetë-dhetë mijë hektare nuk mund të perbâjnë më tepër se katër zona të veçueme.

Neni 2.

a) Mbasi të këtë caktue sypërfaqen ose sypërfaqet që përbâjnë të tetë-dhetë mijët hektarë j mali-përmëndun, Kompania angazhohet me procedue në këto veprime si mbas kushditave që vijojnë:

b) Se Kompania ka me pasë të drejten absolute me bâ studime gjeologjike edhe sondazhe kerkimesh në këto sypërfaqe, për të cilat bâhet fjalë në nenin 1.

c) Se Kompania angazhohet me gërmue,

brenda Periudhës Kërkimeve të parapamë këtu poshtë, të paktën një pus për ç' do shtatëmijë hektarë nga sypërfaqet të rezervuarme prej saj si mbas nenit I.

Gjysma e numrit këtyre puseve, por jo një numur më i math se tri.

kanë me u çpue deri më një thellësi prej një mijë metra të paktën, përveç rastit ku petroli do të gjendet më një thellësi më të vogël.

d) Se Qeveria angazhohet me i dhënë Kompanisë tënë lehtësinát, tue e largue ç'farë do kundrështime ose ndalime të perparimit veprimeve.

e) Në mbarim të ç'do trimestri Kompania detyrohet me i dhënë Qeverisë raporte të imtueme detaillësi gjithfarësh tue bashkëngjitun kopje pllamësh të pregatituna e të dorëzueme Kompanisë nga ana e agjentëve të saj, si edhe gjith mostrat e lëndave të gjetuna.

Neni 3.

Kompania ka me pas të drejtë me importue e me exportue, si mostrë (à titre d' echantillons), sasie të arësyeshme lëndash nga gjith llojnat që janë tregue më sult, e që janë gjet prej saj (Kompanisë) në kohë të studimeve. Kompania ka me pasë edhe obligatën, sapo të jetë e mundun (convenable), me mbush ç' do gropë që âsht bâ edhe me e rafshue sypërfaqen, sa të jetë e mundun, e me e prue në gjëndjen të më pareshme.

Neni 4.

a) Ç' do i treti, që i' i dâmtohet prona

prej Kompanisë në vazhdim të veprimeve që Shoqnia ke të drejtë me bâ, do të çpaguhet me një herë prej Kompanisë, me një shpërblim të drejtë (equitable).

b) Gjith kështu Qeveria do të çpaguhet për ç'do llol obligate që do t'i ngarkohet prej ç'do personi të tretë nga shkaku i veprimeve të sipërmarruna prej Kompanisë.

c) Shuma e çpagimit, që do të gaguhet ndër kondita të naltpërmëndona, në rast mos-marrëveshtjeje në mes të dy palëve, do të caktohet prej arbitrësh që do të emnohen nga prozari i tokës e nga Kompania. Numuri i arbitrëve do të caktohet me një akord të përbashkëtë midis të dy palëve. Në rast të një mos-marveshtjeje në mes të arbitrëve, këta do të zgjedhin një sypërarbitrë. Vendimi i sypërarbitrit do të jetë definitif. Në qoftë se arbitrët nuk bien në godi mbi personin të sypërarbitrit, puna do t'i referohet gjykatores Shqyptare kompetente.

d) Për sa i përket pagesës të çpagimit të vendosun, duhet marrë para sysh vlefta ordinare e tokës, pa-mvarësisht (independement) prej ç'do konsiderate të implikueme në këtë kovencion.

e) Pagimi i çpagimit do të bâhet mbrenjë muaji qysh prej datës vendimit t'arbitrëve ose të sypërarbitrit.

f) Në rast ku, në kohë të veprimeve të përmenduna në këtë konvencion, tokët do të dâmtohen më një shkallë që t'i bâjë të papërdorueshmë për levrim (culture), ose kur

do të jenë të zënuna për një periudhë q'e kalon vitin, prona ri i një të tille toke ka me pas të drejtë me kyp exproprimin si mbas ligjit në fuqië.

Neni 5.

a) Qysh prej datës të notifikimit të premë (formelle) për të zgjedhunit të sipërfaqeve ashtu si âsht caktue tek neni I. do t' i jepet Kompanisë një periudhë tre vjeç, mbrenda së cilës periudhë Kompania ka me pas të drejtë me caktue sipërfaqet për kërkime të imtueme e për sondazhe shfrytzimesh.

Kjo periudhë tre vjeç, që në sa vazhdon do të emnohet, «Periudha e Kërkimeve,» në akord të bashkëtë, mund të zgjatet me një tjatër periudhë të arësyeshme, në qoftë se rethina të veçanta e kypin, (le raisons desirables) edhe në rastin për të cilin flitet në paragrafin që vazhdon.

b) Periudha e kërkimeve nuk mundet të deklarohet e kalueme, pa lejen e Kompanisë, veç se një muaji mbasi të marrë funt periudha e kërkimeve e q' do misi të tretë (tierce partie), që do të këtë fitue të drejta analloge prej Qeverisë para se të nënshkruhet ky konvencion.

c) Mbas datës nënshkrimit të këtij konvencioni as një drejtë explatimi ose forazhimuk mund t' i jepet as një misi (partie) mbi as një pikë të tokave të rezervueme prej Kompanisë si mbas nenit I, deri sa Kompania të këtë ushtrue (exercé) të zgjedhunit e saj prej

resë-dhetë mijë hektarëve për t'i explouatue ajo vehtë, ashtu si asht caktue tek ky nen.

d) Këto të drejta për zgjedhjen në fjalë kan me ju shtrue (seront soumis) konditave që vazhdojnë:

e) Tue filue qysh prej datës 12 Maj 1925 deri në mbarim të Periudhës Kërkimevo, Kompania ka me pasë të drejtën exklusive për me zgjedh sypërfaqe për kërkime të imtueme e për sondazhe shfrytzimesh ndë sypërfaqet që kan me u lanë, me u lëshue ose me u kthye prej cilit do mbsi të tretë qi të jetë, e të cilat sypërfaqe do të kenë marrë, nga shkaku i të drejtave petrolli edhe të tjerave lënda të përmenduna tek nemi I. të drejta të fituemo prej Qeverisë para datës të nenshkrimit të këtij konvencioni.

f). Se sypërfaqet e caktueme si mbas kushtes të këtij neni nuk duhet të kapërxejnë shumën prej pesë-dhetë mije hektare, të cilat nuk kan me u zgjedh përveç se mbi sypërfaqet të koncedueme Kompanisë si mbas kushtet nenit të 1 edhe si mbas kushtet të paragrafit «e» të këtij nenit. Kompania i njef çdo sipërmarrjeje të mbsave të tretë të drejtën e kalimit mbi të posdhetë mijët hektare të zgjedhuna prej saj, me baria (avec conduits) ose të tjera mjete transporti.

(g) Se Kompania ka me i paraqit Qeverisë një raport çdo gjashtë muaj mbi perparimet e bëme në këto forazhe bashkë me një kopje të gjith planeve edhe hartave të nevojshme, edhe se Kompania gjith kështu ka me paraqit të gjith informat shtimtare

(supplementaires) që Qeveria do t' i shohë të nevojshme.

h) Se një Komision Teknik do të formohet, i përbâmun prej gjashtë anetarësh, tre nga këta do të jemnohen nga Qeveria e tre nga Kompania. Ky Komision do t' i vërtetojë konditat e tokave e do të vretojë (surveiller) të krpemit të detyrave nga ana e Kompanisë.

Në rast ku kanë me u çfaq vështirsinat të cilat do t'i pengojshin seriozisht të krpemit të programit, Komisjoni ka me muejt me vendue një rrizim të arësyeshme të këtij programi.

Komisioni ka me pas edhe fuqië për me bâ një zdrypje nëpër të gjitha obligatat që u përkasin gërmimeve, si për punë të kërkimeve si edhe për punë të shfrytzimit, në rast ku rrathinat e veçanta kan për t' a bâ të dëshërueme një masë kësoj doreti.

i) Se ç'do kohë të Periudhës Kërkimeve Kompania ka me pas të drejtën me zgjeth, e liré nga çdo barrë pose atyneve të parapamo (prévue) në ket konvencion të tanë ose një pjesë të syperfaqeve, që do të kenë zgjedhun si mbas kushtet të këtij neni, mbi syperfaqet për të cilat bahet fjalë tek neni I i kësaj marrveshtjeje, me qëllim me i shdrivillue e me ba ndër këto kërkime të masandajshme (ulteriers) për të nxjerrun (obtenir) petroll osc ç'do landë drej atyneve nalt-përmënduna.

j) Se në ç'do kohë të Periudhës Kërkimeve, mbas datës 12 Maj 1925, Kompania ka

me pasë të drejtë të zgjedhë, me mënyrën të shënueme në paragrafin e ma parëshme të tana ose një pjesë të sypërfaqeve që ajo do t' i këtë zgjedh si mbas kushtet të paragrafit «e» të këtij neni, me qellim me i shvillue e me i shfrytzue si mbas mënyrës të parapame (prëvue) në paragrafin e ma parëshme.

Neni 6.

Kompania ka me pasë të drejtën eksklusive të shfrytzimit e të kërkimeve mbi syperfaqet që do të kesë zgjedh si mbas nenit 5 për petroll ose për kripë ose një pjesë të landave sipërtreguemë, deri me 31 Mars 1885.

Këto të drejta do t' u shtrohen (sëroot soumis) kondítave që vazhdojnë:

(a) Se ka për t' u formue një kompanì Amerikane nën titullin, «Americano-Albanian Oil Company» që në sa vazhdon ka m' u emnue, «Kompania e Veprimet».

(b) Sa kapitali i autorizuem i Kompanisë nuk do të jetë më i vogel se dy million e pesë qint mijë dollare, në akcione prej pesë dollarësh si cila e do të munt të shtohet, në qoftë se Kompania e gjen punë të nevojshme.

Pesë muaj para emisionit të ç'do kapitali në akcione, Kompania do të deftohet me informue Qeverinë mbi qëllimin që ka për t'a bë emisionin respektif e në tre muejt e para të kësaj kohe prej pesë muaish, nënshtetasit Shqyptarë do të munden të nënshkruajnë dyzet për qint të këtij kapitali n' akcione, me çmimin të emisionit, e në rast kur këto akcione ose një pjesë e tyne nuk do të jetë e

nënshkrueme (souscrire) prej nënshtetasve Shqyptarë, Qeveria në dy mnajit që mbesin do të ketë të drejtë me nenshkrue të gjitha ose një pjesë prej akcioneve në fjalë, tue pas parasysh gjithmonë që shuma e akcioneve të nënshkrueme nuk do të mundet me e ndalue kufinin të dy-zetve për qint.

(c) Se një kopja e bilancave të përmotëshme të kompanisë Veprimeve do t' i komunikohet Qeverisë

(d) Se Qeveria do të ketë të drejtë me emnue një anëtar në Këshillën e Administratës Kompanisë veprimeve

(e) Se Kompania do të dëtyrohet me ja lëshue Kompanisë veprimeve konçesionin që do t' i jetë dhanun asaj me gjithë të drejtat edhe privilegjet të përkatëshme me qëllim që veprimet e expluatimit, shdrivillimit ose të explorimit tokave që përbajnë objektin e këtij konvencioni të jenë sipermarrë e të vazhdueme prej Kompanisë Veprimeve,

(f) Se Kompania e Veprimeve do të dëtyrohet me pague një redevance prej tre-mbëdhetë e gjymës per qint mbi prodhimin e petrollit brut, që do t' jetë sjellë prej pusave në rezervuarët të vendueme, me parë (en éspèhe) ose me lanë (en nature). Pelqimi i njanës prej këtyneve të dyja i lihet Qeverisë.

Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë të rrëxo e nga shuma e petrollit të prodhuem me mënyrën të difiueme në paragrafin e përparëshme, çdo sasië që ajo ka për t' a prishë për të gjitha punët që janë në lidhje me

shfrytzimin; kështu që redevanca do të llogaritet mbi bazë të sasiës që mbetet mbas rrëximit për të cilin flitet këtu.

Në mbarim të ç' do trimestri Kompania asht e obligueme me ja parashtrue Ministrë Punve Botore një raport tue treguem sasiën të petrollit të prodhuem si edhe tue çfaq mënyrën qysh ka me u disponue kjo sasië. Redevanca do të llogaritet në bazë të sasiëve që figurojnë në këto raportë.

(g) Se Kompania e Veprimit do të detyrohet me pague një qira të permotëshme prej një e gjysmë franga ari për hektar, për ato sypërfaqë që do t' i jenë lëshue në konformitet me nenin 5.

Kompania do t' i paguajë Qeverisë qiranë për dy vjetet e para në muajin që pason ratifikimin e këtij konvencioni.

(h) Se pas formimit, Kompania e Veprimit angazhohet me vue në zbatim programin e forazhit që vazhdon:

Brenda vitit të parë 1,500 metra;
Brenda vitit të dytë 3,000 metra mâ teprë;
Brenda vitit të tretë 4,000 metra mâ teprë;
Brenda vitit të katërtë 4,000 metra mâ teprë;
Brenda vitit të pestë 4,000 metra mâ teprë;

Teprica, në qoftë se do të ketë, prej ktyne numurave metrash në ç' do vit do të llogaritet për të plotsue numurin e metrave të vitit që pason.

Me gjith këto, në qoftë se brenda pesë vjeteve të sypërshënueme, pasat e gërmeeme mbrijnë në prodhim të tre-muajshmë prej nji

zet-e-pesë mijë tonellata, Kompania do të ketë të drejtë me i kadallue (relantir) punët e gërmimit, por do të shtrëngohet t' i fillojë përsëri gjithmonë brenda pesë vjeteve të para që pas programit në krye dëri sa përsëri të mbrinjë më një-zet e pesë mijë tonellata.

Komisioni Teknik do të jetë kompetente me vendue një zdrypje të arësyeshme të këtij programi, në qoftë se kjo duket je dëshërueshme në konsiderim të veprimeve të përgjithëshme të Kompanisë e të naturës si edhe të konditë tokave petrollifere.

Mbas pesë vjeteve të para Kompania e Veprimit ngarkohet me bâ të gjitha përpjekjet e arësyeshmë për me zhdrivillue graden mâ të naltë, që âsht e mundun, për shfrytzimin e dejve (gisements) petrollifere në sypërfaqet e konçedueme e do të rregullojë programin e gërmimit në konformitet me ato që u tha mâ nalt mbas një këshille me Komisionin Teknik.

(j) Se Kompania e Veprimit do të ketë të drejtë me lânë (abandonner) ç' do pjesë të tokave që do t' i jenë dhânë asaj; kjo e lânë e tokave do të tërheqë liberimin e Kompanisë prej të gjitha obligatat që rezulltojnë prej këtij konvencioni për ç' ka u përket tokave të lâna.

(j) Se dy qint mijë franga ari do të depozitohen në kohën e nënshkrimit të këtij konvencion në një Banke të New-Yorkut në urdhër të Qeverisë si një dorzânië (garantie) për exekutimin e mirë të neneve të këtij kon-

vencioni.

Shuma nalt-përmëndun e garantisë do të jetë e pengueme për gjith periudhën e kërkimeve edhe do të bahet pronë (propriété) e Qeverisë në qoftë se Kompania nuk do të kishte mbushun dëtyrat që merr me këtë konvencion kundrejt Qeverisë.

Por me të marrë lunt periudha e kërkimeve, ose në qoftë se Komisioni Teknik do të ketë konstatue një përfundim negatif në ç' ka u përket kërkimeve, aqo në qoftë se Parlamenti nuk do t' a ketë vërtetue konvencionin, Qeveria Shqyptare angazhohet me e lajmue Bankën e sipërthanme që të kthenet shuma në fjalë në dispozicion të Kompanisë.

(k) Se në mbarim të periudhës konçesionit, d. m. th. më 31 të Marsit 1985, krejt materiali që gjendet në Shqypnië: instalacione, ndërtesa, deboja, pusa, rethina (quais), rruga e urra që i përkasin Kompanisë Veprimeve do t' i jepet në dorë Qeverisë gratis.

(l) Se kur Kompania e Veprimit do të ketë nevoje për rruga, ku munt të kalojnë karrocat, e për tramways të nevojshme për shfrytzim, Qeveria do t' i japë kalim të lirë pa fare shpërblim mbi rrugët.

(m) Qeveria do t' i japë Kompanisë të të drejtën e ndërtimit e tëpërmbajtunit për nevojat e saja, të buriave (conduits), vija telefonike, telegrafa pa tel, telegrafa, ropë-ways ajrit, rruga të hekurta e tramways për aqe sa do të jenë exklusivisht të përdorueme për shërbimin e industrisë petrolifere, rruga e

rrethina (quais) e ura, që tue u nis nga to-kat që përfshin koncesjoni i veht do të mbrinjë në ç' do pikë të bregut-detit, që Kompania ka për t' a gjet të pëlqyeshme (convenable). Ajo ka për të pas edhe të drejtën e ndërtimit të bilave për punëtorët e veh!, të uzinave edhe të rafinerive.

Për këtë qëllim ajo do të kete të drejtë që t' i leshohen toka që u përkasin ajerëve privatë me mënyrën e expropriimit në konformitet me ligjet në fuqi. Të çmuemit e tokave për t' u expropritu do të bâhet pa-mvarësisht prej ç' do konsiderate të implikueme prej koncesionit për të cilin bâhet fjalë në këtë konvencion.

Për sa u përket tokava botore jo të zâna me, këto do t' i lëshohen gratis nga Qeveria.

(n) Se Kompania edhe Kompania e Veprimit do të kenë të drejtë me importue në Shqypnië, të lirueme prej ç' do takse doganore, krejt materialin edhe veglat që do t' i duhen asaj.

(o) Se Kompania do të ketë të drejtë me exportue petrolin brut; asfaltin, serën e prodhimet sekondare pa pague as nja taksë exportimi.

(p) Se Kompania edhe Komponia e Veprimit do të jenë të përjashtueme prej ç' do takse speciale, reale ose personale.

(q) Se nëpunësat edhe punëtorët që merren në shërbim prej Kompanise Veprimit do të jenë nga nënshtetësia Shqyptarë, pose drejtorëve, teknicianëve, experiëve edhe speciа-

listëve.

(f) Se në rast kur një rafinërië do të installohet eventualisht në Shqypnië prej Kompanisë Veprimit, Kompania merr mbi vedi barrën t' u përgjegjet kërkeseve për voj-guri e për prodhime sekondare që janë fare të domosdoshme për nevojat e Qeverisë, me çmimin pazarit, tue bâmun një zbrytje prej dhetë për qint; me gjith këto kërkimet e Qeverisë nuk do të mundin të kapërxejnë të njëzetat për qint të prodhimit neto, mbasi të jetë zbryp sasia e vojit të gurit të konsumuom për punëtrat e Kompanisë.

Ç' do kërkesë e Qeverisë Shqyptare që kapërxen të një-zetën për qint asht u edhe gjith kërkesat per tregëtië ose për qëllime të tjera në Shqypnië, do të pranohen para se të exportohet voji-i-gurit me çmimin e pazarit.

Kur prodhimi trimestrial i vojit-të-gurit brut do të jetë prej dhetë mijë tonellata e nalt, dhe në Shqypnië dhe nuk do të jetë ngrehun rafinëria, që u përment më sipër, Kompania detyrohet t' i japë (fournir) Qeverisë Shqyptare ç' do trimestri gjashtë qint e një zet e pesë tonellata voj-guri shndritës (lampant) dhe shtatë-dhetë e pesë tonellata benzinë me dhetë për qint më pak se çmimet e pazarit.

Neni 7.

(a) Në rast kur punëtrat të Kompanisë ose të Kompanisë Veprimit do të jenë pre, ose ndalue (interrompus) ose pengue, nga ngjarje të forcave majore të ngjame prej ci-

lit do shkak, periudhat e kohëve të parapa si maximum në këtë konvencion do të pushojë së vazhduari për gjith kohën e ngjarjeve të forcës majore.

(a) Personalli dhe materiali i Kompanisë dhe i Kompanisë Veprimit në ç'do kohë do të gëzojë mprojtjen e Qeverisë Shqyptare.

(c) Në qoftë se Qeveria Shqyptare vendos mos pranimin e shkakut që Kompania ose Kompania e Veprimit e deklaron si të forcës majore, kjo mos-marrveshtje do të vihet nën arbitrazh si mbas rregullave të nenit 10.

Neni 8.

Anët kontraktuëse dëtyrohen njëra kundrejt tjatrës të lehtësojnë zbatimin e kondita-ve të parapame në këtë konvencion.

Neni 9.

Në qoftë se Kompania nuk do të plotësojë angazhamentet e saja që rrjedhin prej këtij konvencioni, Shteti do të kesë të drejtë të i kërkoj vërejtjen tuj e fiuc t'u konformohet brenda tre muajve angazhamenteve të sipërmarruna. Në qoftë se në mbarim të këtij afati Kompania nuk do të jetë konformue, Shteti do të ja referojnjë punën për nji herë arbitrazhit si mbas nenit 10. Në qoftë se mbas arbitrazhit, Kompania ngel kambi për mos plotësimin e angamenteve, Shteti do të kesë të drejtë të anuloj (résilier) këtë konvencion.

Neni 10.

Në rast të ç'do mos-marrëveshtjeje midis Qeverisë edhe Kompanisë veprimit që i përket interpretimit të drejtave dhe obligata-

ve të dy anëve kontraktuëse që rrjedhin nga dispozitat e këtij konvencioni, çështja do t'u referohet tre arbitrëve, nga të cilët njëni do t'emnohet prej Qeverisë, një tjatër prej Kompanisë dhe i treti do të zgjidhet prej të dy arbitrëve ne fjalë në marrëveshtje të përbashkët.

Në qoftë se arbitrët nuk merren dot vesht për personin e arbitrit të tretë, ky do të zgjidhet me mënyrën që pason:

Një komitet do të formohet prej pesë anëtarësh, dy prej të cilëve do të zgjidhen prej Qeverisë, dy prej Kompanisë dhe i pesti do të emnohet me shumicën të katër anëtarëve të parë. Ky komitet do të emnojë me shumicë votash arbitrin e tretë.

Në rast kur për çfarë do arësye që të jetë, zgjedhja e arbitrit të tretë nuk do të mund të bëhet prej Komitetit, emnimi i tij do t'i referohet Gjyqit Diktimit Shqyptar.

Neni 11

Për sa u përket veprimeve Kompanisë të bëmuna në Shqypnie, ç'do konflikt i lindur prej tynve do t'u parashtrohet gjyqatoreve të vëndit, posë kur âsht parapa ndryshe në këtë konvencion.

Neni 12

Ç'do informatë e parapame në këtë konvencion, që Qeveria do të kërkojë nga Kompania e Operacionit, kjo informatë do t'i dërgohet kësaj me letrë ose me kablogram, drejtuar Ministrisë Punve Botore. Ç'do informatë e dhanme me letrë do të quhet e marrun tre

dit mbas dicës të mbritjes në destinacionin ordinar mbas dorëzimit saj në zyrën e ekspedicionit.

Neni 13.

Ky konvencion asht bâ Shqyp edhe Frëngjisht në kater copë (exemplaires) të nënshkruemë prej të dy anëve kontraktuëse. Por në rast mos-marrëveshtjeje mbi interpretimin e tij, teksti Frëngjisht duhet t'a zerë rendin parë (doit prévaloir).

Neni 14.

(a) Ky konvencion âsht në fuqie (valable) për një periudhë nië-zet vjeç, tue fillue qysh prej datës të nenshkrimit tij.

(b) Me gjithë këtë Qeveria angazhohet me i parashtrue Parlamentit për vërtetim (ratification) një dekret ligji tue zgjatun afatin e fuqisë (durée de la validité) të këtij konvencioni deri më 31 Mars 1925.

c) Sa për vërtetimin (ratification) si edhe për gjithë çashtjet që i përkasin këtij konvencioni Qeveria angazhohet të favorizojë Kompaninë gjith aqë sa edhe ç'do anë të tretë (tierce partie).

d) Në tekst të këtij konvencioni me fjalën «vërtetim» (ratification) kuptohet vërtetimi i dekret ligjit në fjalë mbi zgjatimin e afatit koncesionit deri më 31 Mars 1985.

Për
Qeverinë Shqyptare
Për
Standard Oil Company of N.w-York